

## GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit  
prill 2018

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" \* Nr. 10, prill 2018

Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit

[www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)



# GJYKATË E HAPUR



### PËRMBAJTJE

#### FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

#### STORIE E SUKSESIT

Procedura e ndërmjetësimit dhe zhvillimet e saj në R. e Shqipërisë dhe R. e Kosovës

#### LAJME

#### GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

#### GJYKATA NË MEDIA

Komunikatat për media të Zyrës për Informim

#### INTERVISTË E SHKURTË

Shpresa Kryeziu

#### SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontakttoni Gjykatën Themelore të Prizrenit



---

## FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

---

*Të nderuar lexues,*

*Drejtësia nuk është qëllim në vetvete. Ajo jepet për njerëzit dhe duhet të perceptohet prej tyre si e tillë. Njerëzit duhet ta ndjejnë thellë që drejtësia është e pavarur, e paanshme, e ndershme, e barabartë për të gjithë dhe e përgjegjshme. Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.*

*Gjykata Themelore e Prizrenit synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org) ku publiku ka qasje edhe në publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme me të cilat publikime gjykata e Prizrenit prinë prej gjykatave tjera për nga numri i publikimeve të tyre. Sa i përket publikimit të aktgjykimeve deri në muajin mars 2018 gjithsej kanë qenë mbi 900 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë. Ky sukses ka arritur falë punës profesionale të bashkëpunëtorëve profesional, Zëdhënëses për Informim me Publikun si dhe me angazhimin e praktikantes nga ana e USAID-it.*

*Përpjekje për avancimin e frymës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës është edhe vazhdimi i publikimit të buletinit nr. 10 që ka bërë një hap pozitiv sa i përket informimit të qytetarëve me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofroj informacione për punën e gjykatës statistikat e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen e mediave dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve. Përveç suksesit që ka kjo gjykatë ka edhe sfidat me të cilat po ballafaqohet çdo ditë. Njëra ndër sfidat kryesore është mungesa e bashkëpunëtorëve profesional, mungesa e stafit administrativ, si dhe mungesa e përkthyesve e të cilat paraqesin një sfidë sa i përket punës së kësaj gjykate.*

*Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur, e cila do të vazhdoi të investojë në forcimin e standardeve profesionale dhe të transparencës.*

**Ymer Hoxha,**

*Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren*


### Procedura e ndërmjetësimit dhe zhvillimet e saj në R. e Shqipërisë dhe R. e Kosovës



Me datën 19.12.2017, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizitoi Eni Çobani, ndërmjetësuesja e mirënjohur nga Shqipëria, ku u prit nga Kryetari i kësaj gjykate z. Ymer Hoxha. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja më për së afërmi e punës së gjykatës, sukseset dhe sfidat me të cilat përballet kjo gjykatë.

Pjesë e rëndësishme e këtij diskutimi ishin zhvillimet e procedurës së ndërmjetësimit në Kosovë dhe e njëjta u krahasua me atë të Republikës së Shqipërisë dhe u pajtuan për bashkëpunim të mëtejshëm në këtë drejtim.

## Publikimet e Aktgjykimeve ne tre mujorin e parë të vitit 2018



Gjkata Themelore e Prizrenit kryeson dukshëm me publikimin e aktgjykimeve të plotëfuqishme. Grafika e mësipërme tregon publikimet e aktgjykimeve të plotëfuqishme në web faqen e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Në këtë rast, Gjykata Themelore e Prizrenit ka arritur që me punën dhe transparencën e saj të jetë ndër shembujt më pozitiv nga të gjitha Gjykatat e Kosovës edhe për fillim vitin 2018.

Në web portalin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, mund t'i gjeni të publikuara mbi 900 aktgjykime të plotëfuqishme, të anonimizuara ne përputhje me nenin 108 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1, pika 1.15 dhe pika 1.23 te Ligjit nr. 03/1-223 per Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 2 te Ligjit Nr. 05/L - 032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L -199 për Gjykatat, nenin 3 dhe 12 te Ligjit Nr. 03/1-215 për Qasje ne Dokumente Publike dhe nenin 1.15 dhe 1.16 te Ligjit Nr.03/1-172 për Mbrojtje të të Dhënave Personale.

Publikimi i aktgjykimeve të plotëfuqishme është një ndër mjetet kryesore për promovimin e transparencës gjyqësore përmes qasjes publike. Prandaj, ky grafikon është dëshmia e radhës e përkushtimit maksimal të gjykatës për të jetësuar praktikat e mira që mundësojnë efikasitet, llogaridhënie, paanshmëri dhe transparencë në punën e saj.

---

## Seanca e improvizuar e praktikantëve, e mbajtur me datën 05.01.2018

---



Praktikantët e Gjykatës Themelore të Prizrenit mbajtën një seancë të improvizuar, e organizuar nga gjyqtari i Krimeve të Rënda, Skender Çoçaj si dhe nën mbështetjen e Kryetarit të kësaj gjykate, Ymer Hoxha.

Kjo seancë u mbajt me datën 05.01 2018 në sallën nr.1 të kësaj gjykate, me fillim në ora 10.00. Trupi gjykues i seances së improvizuar ishte i përbërë nga Driola Susuri, kryetare e trupit gjykues, Besiana Çollaku dhe Hata Çoçaj, anëtare të trupit gjykues. Në rolin e prokurorit të shtetit ishte caktuar Marcel Lekaj dhe në rolin e mbrojtësve ishin Lendi Susuri dhe Lorik Kabashi. Ndërsa i akuzuar ishte Albanit Kryeziu, kurse dëshmitar të rastit ishin Arlinda Mehmeti dhe Mamet Braho.

E dëmtuara në këtë seancë të improvizuar ishte caktuar Hatixhe Gjogaj. I akuzuari ngarkohej për veprën penale grabitje nga neni 329 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Pas përfundimit të kësaj seance, Kryetari i Gjykatës i përgëzoi praktikantët e kësaj gjykate, për punën profesionale që treguan gjatë mbajtjes së seancës së improvizuar dhe i'u uroi suksese të mëtutjeshme në karrierën e tyre.

---

## LAJME

---

### Gjykata priti për vizitë FSK (Forcat e Sigurisë së Kosovës)



Prizren, data 31.12.2017 - Në prag të festave të fund vitit, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan Forcat e Sigurisë së Kosovës. Në këtë takim u diskutuan të arriturat e kësaj gjykate gjatë vitit 2017.

---

(45) Dyzetepesë praktikantë përfunduan praktikën në Gjykatën Themelore të Prizrenit

---



Prizren, 09.01.2018 - Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, Ymer Hoxha ka pritur sot në takim praktikantët e kësaj Gjykate, të cilët kanë përfunduar praktikën njëvjeçare.

Me këtë rast Hoxha i ka falënderuar praktikantët për punën dhe angazhimin e tyre maksimal gjatë kësaj periudhe, në këtë institucion.

„ Ju falënderoj shumë për angazhimin e juaj efikas në Gjykatën Themelore të Prizrenit. Me përkushtimin e juaj maksimal është rritur edhe efikasiteti, sa i përket punës së kësaj Gjykate.

Praktikantët janë angazhuar nëpër Divizione të ndryshme në Gjykatë dhe ata kanë qenë gjithmonë të gatshëm për t’i kryer punët për të cilat kanë qenë të angazhuar. Përvoja që ju keni marrë për një vit në Gjykatë, do të iu shërbej gjithmonë në karrierën e juaj profesionale.”

Kryetari Hoxha u ka uruar suksese praktikantëve në fushën profesionale.

**Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri si dhe Kryesuesi i KGJK, z. Nehat Idrizi vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit**



Prizren – Me datën 11.01.2018, Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri si dhe Kryesuesi i KGJK, z. Nehat Idrizi vizituan Gjykatën Themelore te Prizrenit me ç’rast u pritën nga Kryetari i kësaj Gjykate z. Ymer Hoxha. Vizita kishte karakter pune.

Qëllimi i këtij takimi ka qenë thellimi i bashkëpunimit dhe avancimit të proceseve brenda përgjegjësi të ndërsjella si dhe për tu njohur me rezultatet e punës dhe me sfidat me të cilat ballafaqohet kjo Gjykatë.

Kryetari i Gjykatës themelore te Prizrenit z. Ymer Hoxha gjatë këtij takimi ka njoftuar ministrin Tahiri dhe Kryesuesin Idrizi për rezultatet, aktivitetet dhe sfidat e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Njëra nga sfidat e kësaj gjykate është edhe numri jo i mjaftueshëm i gjyqtarëve, i bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit administrativ, si dhe hapësirat e pamjaftueshme të gjykatës të cilat po e vështirësojnë dukshëm punën e kësaj Gjykate.

Përveç sfidave dhe rezultateve te punës si çështje që u diskutuan në këtë takim ishte edhe procesi i reformimit legjislativ. “Ne si gjykatë kemi dhënë disa propozime për tu amandamentuar Kodet Penale dhe disa ligje të natyrës civile pasi konsiderojmë se praktika gjyqësore ka treguar se disa dispozita janë ta pazbatueshme në praktikë.”



Ne anën tjetër Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahir, si dhe Kryesuesi z. Nehat Idrizi deklaruan se vizitën e tyre po e realizojnë me qëllim që të njoftohen për se afërmi me kushtet në të cilat punon kjo Gjykatë dhe gjithashtu ta njoftojnë Kryetarin për mbështetjen e fuqishme në punën e tyre.

”Realizimi i kësaj vizite është bërë me qëllim që ta informojmë Kryetarin se me procesin e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit presim kontributin e tyre që me të vërtet të bëjmë reforma të thella, ta fuqizojmë ligjin por gjithashtu të bartim edhe mesazh tek qytetarët e vendit se të gjithë qytetarët do të jenë të barabartë para ligjit”. Ndër të tjera Kryesuesi theksoi edhe bashkëpunimin e mirë të gjykatave me Ministrinë e Drejtësisë dhe me KGJK, njëherazi theksoi se ky vit do të jetë vit i sundimit të ligjit, rritjes së transparencës, llogaridhënies, efikasitetit dhe performancës së gjyqësorit.

Sipas Kryesuesit, ”Gjykata e Prizrenit është ndër gjykatat më efikase në Republikën e Kosovës dhe prandaj u bë edhe përzgjedhja e parë e vizitës në këtë gjykatë. Duke i ditur sukseset e kësaj gjykate, shpresoj se edhe ky vit do të jetë vit i suksesit dhe efikasitetit edhe më të madh”, shtoi Kryesuesi Idrizi.

Gjatë këtij takimi, u zhvillua debat shumë produktiv rreth fuqizimit të sundimit të ligjit, ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

---

## Konferenca vjetore e Gjykatës Themelore të Prizrenit

---



17 janar 2018 - Gjykata Themelore e Prizrenit sot mbajti konferencën me media ku u prezantua raporti i punës vjetore për vitin 2017 të kësaj gjykate. Kryetari Ymer Hoxha gjatë prezantimit të raportit të punës për gjykatën ka njoftuar për zvoglimin e numrit të lëndëve të bartura, të kryera për vitin 2017.

### Gjykata Themelore në Prizren

Lëndë të trashëguara në fillim të vitit 2017	Lëndë të ardhura gjatë vitit 2017	Gjithsej. lëndë në punë deri në muajin dhjetor 2017	Lëndë të kryera gjatë vitit 2017	Lëndë të mbetura në fund të vitit 2017
29283	31957	61240	43643	17597

## Gjykata Themelore në PrizrenDega në Suharekë

Lëndë të trashëguara në fillim të vitit 2017	Lëndë të ardhura gjatë vitit 2017	Gjithsej, lëndë në punë deri në muajin dhjetor 2017	Lëndë të kryera gjatë vitit 2017	Lëndë të mbetura në fund të vitit 2017
17175	8217	25392	17521	7871

## Gjykata Themelore në PrizrenDega në Dragash

Lëndë të trashëguara në fillim të vitit 2017	Lëndë të ardhura gjatë vitit 2017	Gjithsej, lëndë në punë deri në muajin dhjetor 2017	Lëndë të kryera gjatë vitit 2017	Lëndë të mbetura në fund të vitit 2017
1361	3095	4456	3061	1395

Këto tabela janë tregues i rezultateve të reformave të cilat janë ndërmarr në gjykatën Themelore të Prizrenit si dhe degët e saj Suharekë dhe Dragash gjatë vitit 2017.

Edhe pse gjykatat vazhdojnë të veprojnë me kapacitete të kufizuara, efikasiteti i gjyqtarëve gjatë vitit 2017 në përqindje ka qenë: Gjykata Themelore e Prizrenit me 136.57%, Gjykata Themelore në Prizren - dega Suharekë me 213.23%, Gjykata Themelore në Prizren - dega në Dragash me 98.90% që është dëshmi e përkushtimit të stafit të gjykatës Themelore në Prizren së bashku me degët.

Vlenë të ceket se statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit i rëndon më tepër Divizioni i Kundervajtjes. Sa i përket lëndëve me peshë si lëndët që i përkasin Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit të Përgjithshëm Penal dhe Civil, është arritur që numri i këtyre lëndëve të zvoglohet dukshëm.

Sipas Kryetarit të kësaj gjykate, gjykatat vazhdojnë të kenë nevojë edhe për gjyqtarë shtesë, për bashkëpunëtor profesional, për përkthyes, për rritjen e numrit të stafit administrative, në mënyrë që të shtohet niveli i efikasitetit kësaj gjykatë. Gjatë periudhës raportuese Gjykata ka bashkëpunuar ngushtë me mediat, OSBE-në, policinë prokurorin me Organizatat Joqeveritare, e në veqanti OJQ “Ec Ma Ndryshe”.

---

**Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit priti për vizitë përfaqësuesit e KFOR-it Gjerman**

---



Prizren, 23.01.2018 - Kryetari priti për vizitë përfaqësuesit e KFOR-it Gjerman, ku i njoftoi mbi punën e kësaj gjykate, mbi të arriturat por edhe sfidat me të cilat përballet kjo Gjykatë.

---

## 30 (tridhjetë) praktikantë sot filluan praktikën në Gjykatën Themelore të Prizrenit

---



**PRIZREN, 01.02.2018** - Gjykata Themelore e Prizrenit ka hapur dyert për 30 juristë të diplomuar të cilët morën Akt Emërimin që të jenë pjesë e programit një vjeçar të praktikës. Këta u pritën nga Kyretari i Gjykatës, z. Ymer Hoxha, i cili i njoftoi me punën dhe strukturën e Gjykatës.

Gjatë periudhës një vjecare, praktikantët do të angazhohen në secilin Departament për të mësuar njohuritë praktike të punës në Gjykatë.

Besojmë se njohuritë dhe eksperiencat e fituar këtu, do t'iu shërbejnë në ndërtimin e një karriere të suksesshme në fushën e drejtësisë.

---

## Nxënësit e Shkollës Fillore "Emin Duraku" vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit

---



Me datën 27.02.2018, në orën 12:00, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan nxënësit e klasave të VI, VII, VIII dhe të IX-ta të shkollës fillore "Emin Duraku" në Prizren.

Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bënë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.

Nxënësit u pritën në njërën nga sallat e gjykimit, ku u prezantua struktura e gjykatës, puna që bënë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me publikun ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura. Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjell reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkte me Kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bënë secila zyre, me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës.

Gjykata do të vazhdoi traditën e bashkëpunimit me qytetarët me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

---

## Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” vizituan Gjykatën e Prizrenit

---



Me datën 12.03.2018, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentët e vitit të parë të Fakultetit Juridik, të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bënë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshëm.

Studentët u vendosen në njërën nga sallat e gjyqimit ku u pritën nga Kryetari i kësaj gjykate z. Ymer Hoxha. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim me studentët dhe përfaqësuesit e gjykatës. Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësitë për takime direkt me kryetarin e gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Gjykata do të vazhdoi traditën e bashkëpunimit me qytetarët, me Universitetin, me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

---

**Grupi i dytë i studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti”  
vizituan Gjykatën e Prizrenit**

---



Me datën 13.03.2018, në orën 12:00, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan grupi i dytë i studentëve të Fakultetit Juridik, të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, - viti i parë dhe i dytë.

Vizita kishte për qëllim njohjen më për së afërmi të punës që bënë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshëm.

Studentët u pritën nga Kryetari i kësaj gjykate z. Ymer Hoxha. Prezantimet fillestare u pasuan me diskutim të hapur me studentët dhe përfaqësuesit e gjykatës. Studentët shprehën interesim për të rejtat që ka sjellë reformimi i sistemit gjyqësor, mundësitë për takime direkte me kryetarin e gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun. Poashtu, studentët shtruan pyetje edhe për programin e praktikës një vjecare në këtë institucion.

Gjykata do të vazhdoj traditën e bashkëpunimit me qytetarët, me Universitetin, me shkollat e qytetit dhe të rajonit.



---

## Takimi i Gjykatës me përfaqësuesit e OSBE-së

---



Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit z. Ymer Hoxha, priti sot në një takim Drejtorin e Zyres Rajonale të OSBE-së në Prizren z. George Katcharava dhe stafin e OSBE-së nga Zyra për Ligj dhe Drejtësi të përbërë nga z. Meriton Pajaziti, z. Ergys Rexha dhe znj. Dhurata Shishko. Fillimisht z. Hoxha vlerësoi lartë bashkëpunimin e vazhdueshëm të Gjykatës Themelore të Prizrenit me Zyrën Rajonale të OSBE-së në Prizren dhe përmendi disa nga sukseset e arritura bashkërisht, siç janë monitorimi i rregullt i seancave gjyqësore, publikimi i raporteve mbi të gjeturat nga monitorimi si dhe organizimi i tryezave të rrumbullakëta. Krejt këto me qëllim të mbrojtjes efikase të të drejtave dhe lirive të njeriut, rritjes së efikasitetit dhe transparencës së Gjykatës. Z. Hoxha informoi anëtarët e delegacionit të OSBE-së mbi të arriturat e kësaj gjykate në zvogëlimin e numrit të lëndëve, rritjen e transparencës dhe ngritjen e besueshmërisë tek qytetarët. Gjithashtu, z. Hoxha përmendi edhe sfidat me të cilat kjo gjykatë përballë aktualisht, mos plotësimi i të gjitha vendeve të parapara të punës, mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë etj. Në anën tjetër, z. Katcharava paraqiti edhe një herë mandatin e OSBE-së, projektet që ky mision planifikon ti realizoj në të ardhmen në fushën e së drejtës, sundimit të ligjit dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Në fund u bisedua mbi thellimin e bashkëpunimit në mes të dy palëve në forma të ndryshme në fushën e ligjit dhe organizimin e vizitave të rregullta.

## GJYKATA NË NUMRA

### Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për vitin 2018, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2018, të ardhura, lëndët në proces, lëndë që janë përfunduar në tre mujorin e parë të vitit 2018, dhe ato të mbetura. Statistikat e punës për tre mujorin e parë të vitit 2018 janë dëshmia numerike e përkushtimit maksimal për ti shërbyer qytetarëve.

Tabela e statistikave

Gjykata Themelore - PRIZREN	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të TREM-I 2018	Lëndët e ardhura gjatë TREM-I	Gjithsej lëndët në punë gjatë TREM-I	Lëndët e kryera gjatë TREM-I	Lëndët e mbetura në fund të TREM-I	Perqindja e lendeve të zgjidhura në TREM-I
Dep.Për Krime Të Rënda	Penale	113	31	144	40	104	129,03
	Paraprake	199	25	224	21	203	84,00
Dep. I Përgjithshëm	Penale	3632	520	4152	792	3360	152,31
	Paraprake	1125	176	1301	56	1245	31,82
	Civile	1346	466	1812	335	1477	71,89
	E.Civile	6189	758	6947	676	6271	89,18
	E.P. Me Burg	31	31	62	35	27	112,90
	E.P. Me Gjobë	612	277	889	204	685	73,65
	Të Ndryshme	0	4344	4344	4344	0	100,00
	Trashegimore	26	26	52	33	19	126,92
	Jashtkontestimore	540	134	674	158	516	117,91
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit	216	44	260	43	217	97,73
	Pregaditore	88	58	146	49	97	84,48
Divizioni I Kundërvajtjes	Kundërvajtje	3480	655	4135	1686	2449	84,48
TOTALI		17597	7545	25142	8472	16670	112,29

---

## GJYKATA NË MEDIA

---

Gjykata ka reflektuar në mënyrë pozitive duke qenë bashkëpunuese dhe ka një nivel të mirë të transparencës. Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2018 – Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar 49 komunikata të cilat kanë pasur për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe shqiptimin e dënimeve në rastet gjyqësore, njoftime për vizitat në gjykatë, takimet e punës dhe tryezat, si dhe ka publikuar mbi 900 aktgjykime të plotfuqishme.



Si gjykata e vetme në Kosovë, Zyra për Informim me mjaft sukses po e publikon numrin e dhjetë (10) të Buletinit Informativ “Gjykatë e Hapur”, e cila është një dritare e transparencës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Jemi tejet të motivuar që këtë mjet të transparencës po vazhdojmë ta mbajmë gjallë.

Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha mediat lokale, të cilat kanë transmetuar në mjetet e tyre informimit në nivel shumë të kënaqshëm ngjarjet dhe materialet e shpërndara nga Gjykata. Ju falënderojmë për kontributin e juaj për një gjykatë të hapur dhe transparente.

## INTERVISTE E SHKURTE

*“ZML është përgjegjëse për procedimin e lëndëve në mënyrë transparente dhe me kohë, për lëvizjen e lëndëve brenda gjykatës nga regjistrimi e deri tek përfundimi, pranon të gjitha dokumentet e paraqitura gjykatës dhe i evidenton ato, krijon dhe ruan dosjet e lëndëve.”*



### **SHPRESA KRYEZIU**

Shefe e zyrës për menaxhimin e lëndëve  
në Gjykatën Themelore të Prizrenit

#### **1. Cfarë përgjegjësie ka ZML (Zyra për Menaxhimin e Lëndëve)?**

*ZML është përgjegjëse për procedimin e lëndëve në mënyrë transparente dhe me kohë, për lëvizjen e lëndëve brenda gjykatës nga regjistrimi e deri tek përfundimi, pranon të gjitha dokumentet e paraqitura gjykatës dhe i evidenton ato, krijon dhe ruan dosjet e lëndëve. Poashtu, detyra të tjera të ZML janë:*

- bënë ndarjen e lëndëve, njofton palët përmes shërbimit të postës, menaxhon rrjedhën e lëndëve brenda gjykatës, siguron publikimin e shpalljeve që kanë të bëjnë me lëndët në tabelën e informimit publik brenda gjykatës;*
- arkivon lëndët e kryera, bënë monitirimin dhe raportimin mbi lëndët e pranuar dhe të kryera;*
- procedon dhe nxjerr certifikata brenda kompetencës së gjykatës, merr të gjitha masat e nevojshme për mbledhjen efektive të taksave dhe gjobave të urdhëruara nga gjyqëtarët.*

#### **2. Për të qenë sa më efikese dhe transparente puna në gjykatë, çfarë duhet të ndërmerret?**

*Gjykata është e hapur dhe transparente me publikun, si dhe duke përfshirë qasjen e të gjitha komuniteteve në gjykatë. Gjykata pranon vizita të shumta, si nga ana e nxënësve të shkollave të mesme ashtu edhe të studentëve të Universitetit të Prizrenit. Kemi një bashkëpunim të mirë me OJQ e ndryshme që veprojnë në qytetin tonë, poashtu gjykata ka edhe web faqen ku bënë publikimin e aktgjytimeve. Gjykata po bënë përpjekje të jashtëzakonshme që të eliminohen situatat jo të dëshirueshme, të rrisë efikasitetin e punës, të krijoj një ambient të mire kolegjal, të rrit nivelin e llogaridhënies, të gjitha këto për zgjidhjen e rasteve në afat ligjor apo të arsyeshëm, gjë që ndikon në rritjen e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë.*

### **3. Si ruhen dhe mbahen shkresat në ZML?**

*Shkresat që kanë të bëjnë me një lëndë përfshihen në dosjen e lëndës në mënyrë kronologjike, siq janë përshkrimi i akteve, numri i faqeve dhe kapja e tyre me spirale. Shkresat e lëndëve duhet të ruhen në raftet e ZML, sipas kategorisë së lëndëve. Mirëpo ky veprim nuk praktikohet, për arsye të mungesës së hapësirave për punë, si dhe për shkak të arsyes kryesore për shkak të numrit të vogël të stafit administrativ, konkretisht referentëve në raport me vëllimin e punëve.*

### **4. Si bëhet caktimi i lëndëve tek gjyqtarët?**

*Caktimi i lëndëve te gjyqtarët bëhet përmes tërheqjes së shortit. Të gjitha lëndët e pranuar brenda një muaji kalendarik nga personeli i administratës së gjykatës caktohen në grumbuj në bazë të numrit të gjyqtarve, dhe në bazë të llojeve të tyre. Lëndët e reja ndahen me rrotacion në aq grumbuj sa ka edhe gjyqëtarë në Departamentin përkatës në gjykatë. Në secilin grumbull vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndës të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti. Tërheqja e shortit bëhet nga gjyqtari respektivisht i autorizuari i tij. Dita e shortit do të jetë e Hëna e dytë e muajit. Kur e Hëna bie ditë pushimi (festë) shorti tërhiqet ditën pasuese të punës. Në të ardhmen caktimi i lëndëve me short mund të bëhet edhe me sistem të mekanizmit të kontrollit elektronik, i cili program është duke u instaluar në gjykatën tonë, ku stafi është duke u trajnuar për përdorimin e këtij programi.*

### **5. Sa efikase është gjykata në ekzekutimin e lëndëve si penale ashtu edhe civile?**

*Gjykata po bënë përpjekje për të qenë efikase në ekzekutimin e lëndëve përmes:*

- zyrës së përmbarimit, dhe*
- zyrës së ekzekutimit të sanksioneve penale*

*Në gjykatën tonë gjatë tre mujorit të këtij viti, nga zyra për ekzekutime të sanksioneve penale, janë ekzekutuar 214 lëndë me dënime me gjobë, dhe 35 lëndë me dënime me burg. Ndërsa nga zyra e përmbarimit janë ekzekutuar 653 lëndë.*

## SI T'I QASEMI GJYKATES?

Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.



Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe.



## A e dini se...?!

### (Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje)

Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;

1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;

1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;

1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;

1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;

1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër;

1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;

1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;

1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.





## Kontaktoni Gjykatën Themelore të Prizrenit

Zyra e Administratës  
Tel: +381 (0) 29/244 122

Adresa:  
**Gjykata Themelore  
e Prizrenit**

Rr. "Ibrahim Lutfiu",  
p.n. Prizren, Kosovë

Vizito:  
[www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU  
PRIZREN TEMEL MAHKEMESI  
BASIC COURT OF PRIZREN

**GJYKATË E HAPUR**  
Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit  
**prill 2018**

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" \* Nr. 10, prill 2018  
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit  
[www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)